



Datë: 27.08.2025
Numër Protokolli: 5764/2025

A.nr.1475/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1475/2025, të datës 25.07.2025, të parashtruar nga ankuesja V.H, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.1475/2025, të datës 25.07.2025, të parashtruar nga ankuesja V.H.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, V.H (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), ka parashtruar ankesë me datë 25.07.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokolli 5087/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.1475/2025, kundër Njoftimit të datës 07.07.2025 për rezultatet përfundimtare të kandidatit fitues, të konkursit me Referencë RN00017837 të datës 08.05.2025 për pozitën “Inspektor i Shërbimeve Publike” të shpallur nga Komuna e Prishtinës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën A.nr.1475/2025 të datës 25.07.2025 të parashtruar nga ankuesi në KPMSHCK; Konkursin e datës 08.05.2025; Njoftimin e datës 07.07.2025 për rezultatet përfundimtare; Parashtresën e ankuesit të datës 18.08.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Vendimin e datës 25.06.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.08.2025; Përgjigje në ankesë e datës 07.08.2025; Aplikacionin e ankueses të datës 04.06.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë plotësuar parakushtet ligjore që të **përfundoi procedimi administrativ** i filluar me ankesën e ankuesit, **sepse**:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Komuna e Prishtinës, më datë 08.05.2025 ka shpallë konkursin me numër Reference RN00017837, për pozitën e punës “*Inspektor i Shërbimeve Publike*”, ku afati për aplikim ka qenë nga data 09.05.2025 deri më 07.06.2025, ndërsa nga shkresat e lëndës arrihet në konstatimin se edhe ankuesja ka aplikuar në këtë konkurs.

Tutje, nga shkresat e lëndës arrihet në konstatimin se konkursi në fjalë ka përfunduar me datë 07.07.2025 sipas Njoftimit për rezultatet përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm të shpallur nga Divizioni i Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, ndërsa ankuesja ankesën në Këshill e ka parashtruar me datë 25.07.2025, kundër procedurës së rekrutimit përkatëse, me pretendimet ankimore për shkelje procedurale dhe materiale, pasi që rezulton se sipas Vendimit të datës 25.06.2025 Njësia e Burimeve Njerëzore ia ka refuzuar aplikacionin me arsyetimin se e njëjta nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit të shpallur me datë 08.05.2025.

Mirëpo, ankuesja me datë 18.08.2026 ka përcjellë parashtrësë, përmes së cilës deklarohet se e njëjta është tërhequr nga ankesa e saj e parashtruar me datë 25.07.2025 kundër konkursit me numër Reference RN00017837, për pozitën e punës *Inspektor i Shërbimeve Publike* të shpallur nga Komuna e Prishtinës, me arsyetimin se nuk ka interes juridik të qëndrojë prapa ankesës së parashtruar, ndërsa parashtesa e së njëjtës e datës 18.08.2025 në Këshill është protokolluar me numër: 5536/2025.

Nisur nga rrethanat e paraqitura si më lartë, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “1. *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*; 2. *Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundohet, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë*” dhe erdhi në përfundimin se ankuesja përmes parashtrësës së datës 18.08.2025 me numër protokolli:5536/2025 është tërhequr nga ankesa e saj e datës 25.07.2025 e parashtruar në Këshill, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se janë plotësuar parakushtet ligjore që të përfundohet procedimi administrativ si në dispozitivin e këtij vendimi, lidhur me ankesën e ankueses A.nr.1475/2025 të datës 25.07.2025.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1475/2025, datë 27/08/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses V.H;
- Komunës së Prishtinës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.